



BASHKIMI EVROPIAN

DELEGACIONI I BASHKIMIT EVROPIAN

Shkup, 26 shtator 2012

Fillim i Tvining projektit
“Ndhmë për Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës për
Kontrollin e Ndhmës Shtetërore”

Qendra Informative e BE-së

Fjalim nga
Ekselencia e tij z. Aivo Orav
Head of EU Delegation

E nderuara Zëvendës Kryeministre, zj. Arifi,
I nderuari Ambasador Ivon,
I nderuari z. Çurlinov,
E nderuara zj. Vankovska,

Ekselenca, zonja dhe zotërinj,

Kam nderin t'u uroj mirëseardhje në fillimin zyrtar të këtij projekti të binjakëzimit. Projekti do të implementohet me ndihmën e Administratës së Britanisë së Madhe.

Për vendin, ky projekt paraqet një hap plotësues drejt afrimit të politikave, standardeve dhe qëllimeve të BE-së. Në territorin e Bashkimit Evropian, Komisioni Evropian është institucioni ekskluzivisht përgjegjës për kontrollin e ndihmës publike të dhënë nga Shtetet Anëtare për aktivitete komerciale. Roli i Komisionit Evropian është të parandalojë qeveritë, të mos u japin përparësi selective ndërmarrjeve, suke shkaktuar kështu shtrembërimin e konkurrencës në treg. Në këto raste, Komisioni Evropian ka për detyrë të hetojë këtë çështje.

Mirëpo, Komisioni Evropian nuk i kontrollon të sjitha shpenzimet publike, për shembull për shërbimet që nuk janë të natyrës ekonomike apo që nuk janë ofruar nga tregu, siç është mbrojtja ose siguria.

Ngjashëm, Komisioni Evropian nuk kontrollon mbështetjen që shtetet anëtare e sigurojnë për të gjithë aktorët ekonomikë, siç janë përqindjet e ulëta të taksave, sepse kjo nuk shtrembëron konkurrencën.

Sigurisht që kjo nuk do të thotë se ndihma shtetërore është e ndaluar; përkundrazi. Në ekonomitë tona, intervenimi qeveritar është i justifikuar, dhe nganjëherë i nevojshëm, për të plotësuar forcat e tregut, në rastet kur ato dështojnë në dhënien e rezultateve të dëshiruara. Për shembull, duke siguruar mundësinë e përdorimit të kapitalit për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme; mbrojtjen e mjedisit; duke inkurajuar shfrytëzimin e energjive të rinovueshme; duke investuar në hulumtim dhe inovacion ose duke joshur investuesit drejt pjesëve të pazhvilluara të territorit, etj.

Më lejoni të përsëris edhe një herë së në gjendjen aktuale të financave globale, është me rëndësi vitale që administratat nacionale të shfrytëzojnë në mënyrë më efikase paratë publike dhe të inkurajojnë shpenzimin në politikat që përmirësojnë zhvillimin, inkurajojnë inovacionin dhe krijojnë vende të reja pune.

Tani, më lejoni të përqëndrohem në projektin që po e fillojmë sot, dhe të them se pse e konsiderojmë të rëndësishëm:

- Do të promovojë përafrimin ligjor në çështjet e ndihmës shtetërore me legjislacionin e BE-së, i cili është një nga synimet për Anëtarësim në BE;
- Do të ndërtojë kompetencat dhe aftësitë në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës;
- Do të informojë organet publike dhe sektorin privat lidhur me dobinë nga rregullat e ndihmës shtetërore dhe do të inkurajojë respektimin e këtyre rregullave;
- Do të përgatisë administratën publike dhe sektorin privat për atmosferën e rregullave me të cilën do të përballen pas hyrjes së vendit në BE;
- Do të përfshijë rregulla më të drejta në treg, duke e lejuar konkurrencën e shëndoshë dhe ekonominë më funksionale të tregut, e cila është thelbësore për të hyrë në Bashkimin Evropian.

Mirëpo, përfaqësuesit e projektit do t'u sigurojnë më tepër informata gjatë evenimentit.

Ju falemnderit shumë për vëmendjen tuaj.